

URDHËR
Nr. 622, datë 13.12.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR REGJISTRIMIN
E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, NË BAZËN E TË DHËNAVE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës; pika 1 e nenit 6, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Për qëllim të këtij urdhri, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) “mjetet transporti” janë automjetet rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore;
 - b) “numër unik i regjistrimit” është një numër i caktuar nga autoriteti kompetent të një stabilimenti të regjistruar;
 - c) “kodi identifikues i kafshës” është kodi individual që shfaqet në mjetet e identifikimit të aplikuara për një kafshë, dhe përfshin:
 - i. kodin e shtetit ku mjetet e identifikimit janë aplikuar tek kafsha;
 - ii. e ndjekur nga numri individual identifikues numerik i caktuar për kafshën me jo më shumë se 12 shifra;
 - ç) “kafshë e llojit derr” është një kafshë e llojit thundrak të familjes *suidae*;
 - d) “identifikues elektronik” nënkupton një shenjues me identifikim radiofrekuence (RFID);
 - dh) “baza e të dhënave kompjuterike” nënkupton një bazë të dhënash kompjuterike të kafshëve dhe fermave blegtorale, RUDA;
 - e) “zinxhiri i prodhimit” nënkupton zinxhirin e prodhimit të integruar të një statusi të përbashkët shëndetësor. në lidhje me sëmundjet e listuara, që konsistojnë në një kuadër bashkëpunues të institucioneve të specializuara të miratuara nga SPV-ja, për qëllimin e pikës 5, midis të cilëve kafshët e llojit derr lëvizin për të përfunduar ciklin e prodhimit.
2. Operatorët e stabilimenteve, që mbajnë kafshë të llojit derr, duhet të sigurojnë që secila nga kafshët e llojit derr, të identifikohet me mjetet e mëposhtme të identifikimit:
 - a) një matrikull konvencional në vesh ose një matrikull elektronik në vesh, i vendosur në pjesën e jashtme të veshit të kafshës, me një pamje të dukshme, të lexueshme dhe të pandryshueshme të numrit unik të regjistrimit, të:
 - i. stabilimentit të lindjes së kafshës; ose
 - ii. stabilimentit të fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5 të këtij urdhri, në rastin kur këto kafshë zhvendosen në një stabiliment jashtë zinxhirit të prodhimit; ose
 - b) një tatuazh, i aplikuar në kafshë në mënyrë të përhershme të numrit unik të regjistrimit, të:
 - i. stabilimentit të lindjes së kafshëve; ose
 - ii. stabilimentit të fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5 të këtij urdhri, kur këto kafshë lëvizin në një stabiliment jashtë zinxhirit të prodhimit.
3. Operatorët e stabilimenteve që mbajnë kafshë të llojit derr të sigurojnë, që:
 - a) mjetet e identifikimit aplikohen për kafshët e llojit derr, në:
 - i. stabilimentin e lindjes; ose
 - ii. stabilimentin e fundit të zinxhirit të prodhimit të përmendur në pikën 5, kur këto kafshë lëvizin në një stabiliment jashtë këtij zinxhiri të prodhimit;
 - b) asnjë mjet identifikimi nuk hiqet, modifikohet ose zëvendësohet pa dijeninë e autoritetit kompetent.

4. Operatorët e stabilimenteve, që mbajnë kafshë të llojit derr, mund të zëvendësojnë mjetet e identifikimit të përmendura në pikën 2, me një identifikues elektronik të miratuar nga SPV-ja.

5. Në përjashtim nga pika 1 deri në pikën 4 të këtij urdhri, autoriteti kompetent mund të lejojë operatorët e stabilimenteve të zinxhirit të prodhimit të devijojnë nga detyrimi për të identifikuar kafshët e llojit derr, kur këto kafshë synohen të lëvizin brenda këtij zinxhiri prodhues, me kusht që zbatimi praktik i masave të gjurmueshmërisë të sigurojë gjurmueshmërinë e plotë të këtyre kafshëve.

6. Autoriteti kompetent mund të përjashtojë operatorët e stabilimenteve të mbyllura dhe operatorët që mbajnë kafshë të llojit derr për qëllime kulturore, shfaqje ose shkencore nga kërkesat e identifikimit për kafshët e llojit derr të parashikuara në pikën 2.

7. Gjatë dhënies së përjashtimeve të parashikuara në pikën 6 të këtij urdhri, SPV-ja do të sigurojë që një transponder i injektueshëm është autorizuar prej tij për të identifikuar kafshët e llojit derr të referuara në pikën 6 të këtij urdhri dhe që mjete të tilla identifikimi të autorizuar, përputhen me kërkesat e pikës 8 të këtij urdhri.

8. SPV-ja të hartojë procedura për aplikim për operatorët kur ata kërkojnë një përjashtim të tillë, siç parashikohet në pikën 6 të këtij urdhri.

9. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë që mjetet e identifikimit, si: matrikull konvencional të veshit, matrikuj elektronik të veshit, transponderat e injektueshëm dhe tatuazhe, të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) ato pasqyrojnë, ose:

i. numrin unik të stabilimentit të lindjes së kafshës; ose

ii. numrin unik të regjistrimit të stabilimentit të fundit të një zinxhiri prodhues, në rastin e kafshëve që do të lëvizin nga stabilimenti i një zinxhiri furnizues në një stabiliment tjetër jashtë këtij zinxhiri prodhues;

b) ato janë miratuar nga SPV-ja.

10. SPV-ja vendos procedura për aplikim, për:

a) prodhuesit për miratimin e mjeteve të identifikimit për kafshët e llojit derr që mbahen në territorin e tyre;

b) operatorët për mjetet e identifikimit të kafshëve të llojit derr që do të vendosen në stabilimentin e tyre.

11. Informacioni i ruajtur në bazën e të dhënave kompjuterike të jetë në përputhje me rregullat e mëposhtme:

a) informacioni i mëposhtëm duhet të regjistrohet për stabilimentet që mbajnë këto kafshë:

i. numri unik i regjistrimit;

ii. emri dhe adresa e operatorit të stabilimentit;

b) informacioni i mëposhtëm duhet të regjistrohet për çdo lëvizje të këtyre kafshëve për në stabiliment dhe nga stabilimenti:

i. numrin e përgjithshëm të kafshëve;

ii. numrin unik të regjistrimit të stabilimentit të tyre të origjinës dhe të destinacionit;

iii. datën e mbërritjes;

iv. datën e nisjes.

12. Dokumenti i lëvizjes brenda territorit të vendit duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) informacionin e mbajtur në bazën e të dhënave kompjuterike, sipas pikës 11, shkronja “a”, paragrafi “i”, dhe shkronja “b”, paragrafët “i”, “ii” dhe “iv”;

b) numrin unik të regjistrimit të transportuesit;

c) numrin e targës ose numrin e regjistrimit të mjeteve të transportit.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2023.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca